



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2198 prot.

Tiranë, 2. 2.2021

URDHËR

Nr. 23, datë 2.2.2021

PËR

**“MARRJEN E MASAVE DHE MONITORIMIN E PËRDORIMIT TË BURIMEVE  
FINANCIARE DHE LOGJISTIKE TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE  
EKONOMISË PARA ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË VITIT  
2021”**

Në mbështetje të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të neneve 91 dhe 92 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

**URDHËROJ:**

1. Marrjen e masave dhe monitorimin e përdorimit të burimeve financiare dhe logjistike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, para zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2021, si më poshtë:
2. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, ndalohet vënia në përdorim ose në mbështetje të subjekteve zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme që janë në zotërim (pronësi/administrim) të institucionit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
3. Punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ju ndalohet të përdorin të mirat publike, burimet financiare dhe materiale të Ministrisë, me qëllim favorizimin e subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje.
4. Gjatë periudhës zgjedhore, automjetet si dhe karburanti, në përdorim të titullarit, Ministrit apo Ministrisë, ndalohen të përdoren për veprimtari politike e të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhorë ose të kandidatëve në zgjedhje.

5. Për efekt të zbatimit të pikës 4 të këtij urdhri, në mbarim të orarit zyrtar, të gjithë automjetet duhet të parkohen detyrimisht në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky proces materializohet me një procesverbal, i cili nënshkruhet nga personi përgjegjës për ruajtjen e automjetit pas parkimit si dhe nga shoferi që ka në përgjegjësi automjetin. Përrjashtohet nga ky rregull përdorimi i automjetit të Ministrisë, në përmbushje të detyrave funksionale, si dhe rastet e urdhëruara me autorizim për shërbime pune.

6. Procesverbalet që mbahen në përputhje me pikën 5 të këtij urdhri, dorëzohen në fund të ditës pranë zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm.

7. Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bashkëpunim me Drejtorët e Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përmbush detyrat dhe është përgjegjëse për:

a) verifikimin dhe analizimin e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale. Në rast të konstatimit të shkeljeve, merren masat e menjëhershme për dërgimin e denoncimit sipas rastit, në KQZ ose në Prokurori;

b) verifikimin e ndalimit të përdorimit të automjeteve dhe karburantit, për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje;

c) marrjen e masave dhe realizimin e monitorimit të zbatimit të parashikimeve ligjore për të garantuar mospërdorimin e:

- i. fondeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për periudhën 4 muaj përpara, deri në datën e zgjedhjeve, në funksion të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;
- ii. mospërdorimin e mjeteve dhe materialeve në inventar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për periudhën 4 muaj përpara deri në datën e zgjedhjeve, në funksion të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore.

8. Drejtorët e Përgjithshëm të Ministrisë dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, detyrohen të marrin masat përkatëse për zbatimin e parashikimeve të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", si dhe të këtij urdhri dhe të raportojnë periodikisht në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.

9. Ngarkohen subjektet e këtij urdhri të kryejnë detyrat e përcaktuara në këtë urdhër deri në datën 25 prill 2021.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Oltjon MUZAKA**

